



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:055438

Datë: 04.02.2025

Numri i dokumentit: 06796918

C. nr. 1036/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil - gjyqtari Shaban Shala, me bashkëpunëtorin profesional I.S. në çështjen juridike kontestimore të paditësit V.V. nga Prizreni, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av. S.K. nga Prishtina, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal – Prizren, për kompensimin e pagës shtesë për ditët e punës gjatë vikendit dhe rrezikshmërisë, më datë: 03 shkurt 2025, merri këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet poshtë padi në këtë çështje kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi V.V. përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur padi për kompensimin e pagës shtesë për ditët e punës gjatë vikendit dhe rrezikshmërisë, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal – Prizren, me të cilën ka kërkuar nga gjykata të detyron palën e paditur, që për kohën kontestuese prej hyrjes në fuqi të ligjit e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, në emër të pagës shtesë për punën gjatë vikendit dhe rrezikshmërisë të kompensohet paditësi në shumë të cilën do ta precizonë pas marrjes së ekspertizës financiare, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e shkaktimit të dëmit e gjerë në pagesën definitive dhe atë në afat prej 7 ditësh nga dita plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar. Në dispozitiv nuk e ka përcaktuar vlerën e shumës për të cilën kërkon për shkak të kompensimit të pagës shtesë për ditët e punës gjatë vikendit dhe rrezikshmërisë.

Pasi që pala paditëse nuk ka paraqitur shumën e kompensimit të pagës shtesë për ditët e punës gjatë vikendeve dhe rrezikshmërisë, konkretisht që të përcaktojë qartë kërkesën e tij sa i përket ditëve të punës gjatë vikendit duke i përcaktuar që as ditë dhe për cilën periudhë kohore dhe sa është vlera e saktë e kërkesës, për të cilat kërkon kompensimi, gjykata me Aktvendim C. nr.1036/2024 datë 10 qershor 2024, ka kërkuar nga pala paditëse plotësimin e padisë në afat prej 3 ditësh, duke e njoftuar palën paditëse për pasojat e mosveprimit sipas atij aktvendimi.

Përkundër faktit që pala paditëse e ka pranuar aktvendimin e lartcekur, ajo me parashtrësën e datës 24 qershor 2024, për plotësimin dhe përmirësimin e padisë nuk e ka bërë precizimin sa i përket ditëve të punës gjatë vikendit, sa ditë ka punuar dhe për cilën periudhë kohore kërkohet kompensimi në emër të rrezikshmërisë, por i ka propozuar gjykatës që

plotësimin dhe përmirësimin e padisë për ditët e punës gjatë vikendit dhe për periudhën kohore apo prezencën në punë, do ta bëjë pas nxjerrjes së ekspertizës me arsyetimin se tani është e pamundur.

Në kuptim të nenit 99 par. 2 lidhur me nenin 254 dhe 391 të LPK-së, parashihet që padia duhet të jetë e kuptueshme dhe të përmban çdo gjë që nevojitet sipas sajë, kur paditësi me padi kërkon ekzistimin e një të drejte që i takon.

Në rastin konkretë pala paditëse kërkon kompensim të pagës shtesë për ditët e punës gjatë vikendit dhe rrezikshmërisë, mirëpo paditësi përmes të autorizuarit të tij përkundër pranimi të vendimit për përmirësim dhe plotësim të padisë, nuk i ka përcaktuar për sa ditë pune dhe për cilën periudhë kohore kërkon kompensimin. Mbi këtë bazë gjykata nuk ka mundur të vepron sipas padisë dhe precizimit të pa përmirësuar, pasi që në mënyrën si është paraqitur kërkesa, pala e paditur nuk mundë të deklarohej në përgjigjen në padi që do ta paraqiste e cila do të detyrohej nga gjykata që brenda afatit të caktuar të paraqet përgjigje në padi. Për të cilën gjë do të lindnin pasoja për palën e paditur.

Pasi që pala paditëse përkundër faktit që gjykata ka kërkuar përmirësimin dhe plotësimin e padisë, nuk ka vepruar sipas atij aktvendimi. Përkundrazi, me parashtrësën për plotësimin e padisë ajo nuk ka plotësuar dhe përmirësuar padinë. Gjykata në kuptim të nenit 391 par. 1 germa (g), të LPK-së vendosi të hedh poshtë padinë.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2024:055438, 04.02.2025

B. profesional
Ilir Sërtollaj

Gj y q t a r i,
Shaban Shala

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mund të ushtron ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktvendimi.